REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

KUVENDI
NR 3133 DATE 14.12.20

AKT NORMATIV

Nr. 33 **, datë** 11.12.2020

PËR

NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993, "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Pas nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shtohet neni 5/1/b, me këtë përmbajtje:

"Neni 5/1/b
Trajtim i veçantë familjar

Familja, e cila ka humbur aksidentalisht pjesëtarë të saj, si pasojë e veprimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës nga punonjës të organeve ligjzbatuese, përfiton trajtim të veçantë financiar deri në masën e tetëfishit të pensionit social.

Trajtimi i veçantë financiar dhe anëtari që përfiton në emër të familjes, përcaktohet me vendim individual të Këshillit të Ministrave dhe financohet nga buxheti i shtetit.".

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

NR.PROT.6294
DATË 14.12. 2020

KUVENDIT
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

R E L A C I O N

PËR

AKTIN NORMATIV "PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993, "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky akt normativ që paraqitet për shqyrtim dhe miratim ka për synim një ndryshim në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Ndryshimi me akt normativ ka si qëllim dhënien e një ndihme, me karakter të përhershëm, familjes së personit që humbi jetën aksidentalisht si rezultat i veprimeve që një punonjës i Policisë së Shtetit ka kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky akt normativ është në përputhje me kërkesat dhe kushtet e nenit 101 të Kushtetutës.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Vdekja aksidentale e të riut por edhe raste të tjera të ngjashme që mund të ndodhin aksidentalisht gjatë ushtrimit të detyrës nga punonjës të Policisë së Shtetit ose të organeve të tjera ligjzbatuese, përveç dhimbjes për humbjen e personit të familjes, krijojnë edhe vështirësi të natyrës ekonomike për familjen e tij. Duke qenë në moshë aktive për punë janë edhe kontribuesit me të ardhura në

familje dhe po ashtu do të ishin burimi kryesor i të ardhurave për familjen, si mbajtës të familjes. Humbja e jetës aksidentalisht, nga një veprim i punonjësit publik gjatë ushtrimit të detyrës, përveç të tjerave vë në vështirësi financiare familjen dhe e çon atë në varfëri sidomos në rastet kur pjesëtarët e familjes janë në moshë të thyer apo në moshë minorene.

Të ndodhur në kushtet e humbjes së jetës aksidentale të një të riu në moshën 25-vjeçare, në kuadër të marrjes së masave imediate për rehabilitimin njerëzor të familjarëve të dëmtuar shpirtërisht por edhe financiarisht nga humbja e mbajtësit të familjes, propozohet një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Akti normativ synon shtimin e një dispozite me efekt të menjëhershëm që parashikon trajtimin e veçantë financiar për familjen e personit që ka humbur jetën aksidentalisht nga veprimet e punonjësve të agjencive ligjzbatuese në vend. Kjo dispozitë për trajtimin e veçantë financiar krijon mundësinë ligjore për dhënien e një ndihmë me karakter të përhershëm për familjet që kanë humbur pjesëtarin e familjes aksidentalisht nga veprimet e punonjësve të agjencive ligjzbatuese. Ky trajtim do të jepet vetëm për një përfaqësues të familjes i cili do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Konkretisht, në dispozitën e shtuar (neni 51/1/b) nëpërmjet këtij akti normativ përcaktohet si përfituese familja që ka humbur pjesëtarin e saj dhe me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohet emri i anëtarit të familjes që do e përfitojë këtë trajtim.

Më konkretisht, pas nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shtohet neni 5/1/b, me këtë përmbajtje:

"Neni 5/1/b
Trajtim i veçantë familjar

Familja, e cila ka humbur aksidentalisht pjesëtarë të saj, si pasojë e veprimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës nga punonjës të organeve ligjzbatuese, përfiton trajtim të veçantë financiar deri në masën e tetëfishit të pensionit social.

Trajtimi i veçantë financiar dhe anëtari që përfiton në emër të familjes, përcaktohet me vendim individual të Këshillit të Ministrave dhe financohet nga buxheti i shtetit.".

Sipas përcaktimit të mësipërm, familja e të ndjerit përfiton trajtim financiar në masën e tetëfishit të pensionit social (afërsisht 61 000 lekë në muaj) dhe është mbi nivelin e pagës mesatare duke kompensuar mungesën e të ardhurave për familjen nga humbja e jetës.

Me këtë shtesë realizohet qëllimi për t'i dhënë një ndihmë me karakter të përhershëm dhe nuk ngatërrohet me skemën e pensionit duke mos e prekur atë dhe njëkohësisht i lejohet të punojë dhe të kontribujë për pensionet nga skema e detyrueshme.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky akt normativ është hartuar në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Konkretisht, në dispozitën e shtuar (neni 51/1/b) nëpërmjet këtij akti normativ përcaktohet si përfituese familja që ka humbur pjesëtarin e saj dhe me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohet emri i anëtarit të familjes që do e përfitojë këtë trajtim.

Më konkretisht, pas nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shtohet neni 5/1/b, me këtë përmbajtje:

"Neni 5/1/b
Trajtim i veçantë familjar

Familja, e cila ka humbur aksidentalisht pjesëtarë të saj, si pasojë e veprimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës nga punonjës të organeve ligjzbatuese, përfiton trajtim të veçantë financiar deri në masën e tetëfishit të pensionit social.

Trajtimi i veçantë financiar dhe anëtari që përfiton në emër të familjes, përcaktohet me vendim individual të Këshillit të Ministrave dhe financohet nga buxheti i shtetit.".

Sipas përcaktimit të mësipërm, familja e të ndjerit përfiton trajtim financiar në masën e tetëfishit të pensionit social (afërsisht 61 000 lekë në muaj) dhe është mbi nivelin e pagës mesatare duke kompensuar mungesën e të ardhurave për familjen nga humbja e jetës.

Me këtë shtesë realizohet qëllimi për t'i dhënë një ndihmë me karakter të përhershëm dhe nuk ngatërrohet me skemën e pensionit duke mos e prekur atë dhe njëkohësisht i lejohet të punojë dhe të kontribujë për pensionet nga skema e detyrueshme.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ashtu si dhe për kategoritë e tjera përfituese sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar edhe trajtimi i veçantë financiar për kategorinë e përfituesve sipas këtij akti normativ do të bëhet nga Instituti i Sigurimeve shoqërore.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky akt normativ është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky akt normativ do të ketë efekte në buxhetin e shtetit që mund të llogariten aktualisht për 1 përfitues.

KËSHILLI I MINISTRAVE